



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 46
Prishtinë, më 5.05. 2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Heset Cakolli, Mark Krasniqi, Donika Kadaj –Bujupi, Adem Hajdaraj dhe Dragan Dimiq.

Munguan : Memli Krasniqi.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i KDI - së, NDI - së, përfaqësues nga mediat Koha Ditore dhe Kosova Sot, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.04.2010
3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian në fushën e kulturës
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - propozoi të diskutojmë për nën pikën në të ndryshme, pasi nuk ka arrit me kohë Ministri i Kulturës.

Më këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit, dhe u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.04.2010.

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i mbledhjes së 27.04.2010, u miratua me plotësim të fjalisë së Drita Kadriu.

3. Të ndryshme

Arsim Rexhepi- kryetar, njoftoi anëtarët e Komisionit për rrjedhën e punimeve të cilat janë duke u kryer në pjesën në të dy anët e Urës së Gurit në Vushtrri, dhe theksoi se sot ka arrit përgjigja me shkrim nga kryetari i Komunës Bajram Mulaku, të bashkangjitura Vendimi i K.K, pëlqimi i Institutit të Kosovës për mbrojtje të monumenteve, Vendimi i ICO.

Ai propozoi që kjo pikë të diskutohet në njërën nga mbledhjet e radhës.

Donika Kadaj-Bujupi, theksoi se në bazë të procedimit të kërkesës sonë dhe autorizimit nga ana e komisionit, javën e kaluar ka pas takim me ambasadorin e Shqipërisë, ku është informuar për rrjedhën e procedurës së Komisionit homolog të Shqipërisë, dhe i njëjti ka informuar se mund t'i mbulojë shpenzimet e komisionit tonë në përbërje 5+1, ndërsa ka mbet që komisioni të konfirmojë datat e sakta për periudhën 20 deri 30 qershor. Njëherit propozoi, që gjatë realizimit të vizitës duhet të vejmë një kontakt me kryeparlamentarën e Shqipërisë.

Nëse komisioni vendos të shkojë në përbërje të plotë atëherë një pjesë e anëtarëve duhet të financohet nga buxheti i komisionit apo do ti përcjellim procedurat teknike në Kryesi. Anëtarët e Komisionit lidhur me vizitën në Shqipëri, u pajtuan për datën 24 deri 26 maj.

Kryesuesi – theksoi se vizita në Shqipëri do ta realizohet në përbërje të plotë të Komisionit, ndërsa për mbulesë të kostos financiare për disa anëtarë dhe stafin mbështetës, do të rishqyrtojmë mundësin e buxhetit të komisionit apo do të procedojmë me shkrim në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi - konsideron se është mirë që Komisioni ti zbatojë procedurat zyrtare dhe për çdo informatë duhet të njoftohet komisioni e jo anëtarët e komisionit. Në fjalinë e tij tha, se komisioni në mënyrë procedurale iu është drejtuar Ambasadës së Shqipërisë për një vizitë me komisioni homolog të Shqipërisë dhe lidhur me këtë çështje kërkoi sqarim nga Donika Kadaj, pse Komisionit nuk është informuar me shkrim.

Donika Kadaj-Bujupi –mendon se diskutimet e tilla nuk janë reale andaj theksoi se angazhimi i saj është për tu falënderuar.

Ajo konsideron se takimi me ambasadorin e Shqipërisë është bërë në cilësinë e deputetes dhe atë në bazë të autorizimit nga ana e komisionit, me qëllim të përshpejtimit të proceduarës komfor kërkesave tona. Në fund tha se nuk do të merr pjesë në këtë vizitë.

Drita Kadriu, - mendon se është më drejtë të respektohen procedurat në formë të shkruar. Ajo theksoi se Komisioni duhet ta konfirmojë Ambasadën e Shqipërisë me shkrim për datën e vizitës dhe e njëjta të procedohet në Kryesi.

Enis Kervan, - në bazë të plan programit të vitit të kaluar si pikë e veçante ka qen vizitat, në atë periudhë ish kryetari Agim Veliu, ka autorizuar Donika Kadaj dhe mua për organizimin e vizitës në Shqipëri dhe në Turqi, andaj mendon se kjo punë është për tu vlerësuar.

Heset Cakolli, - pajtohet me parafolësit lidhur me vizitën me Komisionin homolog të Shqipërisë, që komisioni të shkojë në përbërje të plotë së bashku me stafin mbështetës, njëkohësisht pajtohet për datën e vizitës. Ai theksoi se është për tu falënderuar angazhimi i Donika Kadaj dhe Enis Kervan, lidhur me organizimin e këtyre vizitave.

Komisioni mur qëndrim që në mbledhje të radhës, të propozohen emrat e ekspertëve për plotësimin e listës së ekspertëve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian në fushën e kulturës

Kryesuesi- i njoftoi anëtarët e Komisionit se në këto çaste ka marr telefonat nga Ministri i Kulturës i cili tha se agjenda ka qenë shumë e ngarkuar, andaj kërkoi falje për mospjesëmarrje në këtë takim, i njëjti ka shprehë gatishmëri se do jetë prezent në çdo kohë që kërkon komisioni.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi